



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

Numri i lëndës: 2019:077691

Datë: 10.01.2025

Numri i dokumentit: 06781608

**2019:077692**

(P.nr.286/19)

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me bashkëpunëtorin profesional Shkelzen Poloviqi , në çështjen penale kundër të pandehurit S.D. nga fsh. .... , për shkak të veprës penale Vjedhje nga neni 325 par. 1 të Kodit Penal të Kosovës ( KPPK-së ), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II nr. 96-5/19, të dt.26.02.2019, konform nenit 106 par. 1 pika 5 të KPPK-së dhe nenit 248 par.1 nën par. 1.3 të KPPRK-së, me dt.10.01.2025 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

Hudhët aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II nr. 96-5/19, e dt.26.02.2019, ndaj të pandehurit S.D., nga i ati E., i lindur më ....., me vendbanim në fsh. ... K. ..., nr. personal ..., për shkak të veprës penale Vjedhje nga neni 325 par.1 të KPPK-së, dhe pushohet procedura penale për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore.

**A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II nr. 96-5/19, të dt.26.02.2019, ka ngarkuar të pandehurin për shkak të veprës penale Vjedhje nga neni 325 par.1 të Kodit Penal të Kosovës (KPPK-së) dhe ka kërkuar që i pandehuri të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Nga dispozitivi i aktakuzës rezulton se vepra penale është kryer me datë 24.12.2018 dhe për këtë vepër penale Vjedhje e nga neni 325 par.1 të KPRK-së, është paraparë dënim me gjobë dhe me burgim deri në 3 (tri ) vite.

Në nenin 106 par.1 pikë 5 të KPPK-së, parashihet se ndjekja penale për vepra penale të dënueshme deri 3 (tri) vite burgim, nuk mund të ndërmerret nëse ka kaluar afati prej 3 /tri/ viteve nga data e kryerjes së veprës penale-parashkrimi relativ, e në rastin konkret janë ndërmarr disa veprime me të cilat është ndërpre parashkrimi relativ, mirëpo deri më datën e nxjerrjes së këtij aktvendimi tani kanë kaluar mbi 6 (gjashtë) vite dhe për këtë ka arritur parashkrimi absolut dhe rrjedhimisht ndjekja penale më nuk mund të ndërmerret për shkak se ka ndodhur parashkrimi absolut i kësaj vepre penale.

Në nenit 107 pika. 8 të KPPK-së, thuhet se ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (parashkrimi absolut i ndjekjes penale) e që në rastin konkret nga data e kryerjes së veprës penale që data 24.12.2018, kanë kaluar më tepër se 6 (gjashtë) vite, e që nënkupton se në këtë çështje penale ka ndodhur parashkrimi absolut dhe më nuk mund të bëhet ndjekja penale.

Konform nenit 453 par.1 të KPPRK –së, shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore.

Nga arsyet e lartcekura, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Komfor nenit 453 par.1 të KPRK –së, shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**DEPARATAMENTI I PËRGJITHSHËM- DIVIZIONI PENAL**  
**2019:077692 (P.nr.286/19) , datë 10.01.2025**

**Bashkëpunëtori profesional**

**Shkelzen Polloviqi**

**Gjyqtari i vetëm gjykues**

**Imri Sejda**

**KËSHILLA JURIDIKE:** kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 3 /tri/ ditëve nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktvendimi, përmes kësaj gjykate.